

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-4135/24

Klinë, dt 10.12 /24

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 25.04.2024, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyetarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSBB-së dhe prezantoi rendin e ditës.

1. *Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;*
2. *Siguria dhe analiza e shkaktarëve të vjedhjeve në territorin e Komunës së Klinës;*
3. *Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e Komunës;*
4. *Të ndryshme.*

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Unë procesverbalin e kam në email dhe po shpresoj që të gjithë ju e keni dhe e keni lexuar. Nëse ka dikush diçka për të shtuar në lidhje me procesverbalin, le të urdhërojë, nëse nuk ka dikush diçka, atëherë ju ftoj që ta miratojmë!

Dhe para se të fillojmë te pika e dytë e rendit të ditës, jam e obliguar të ju sqaroj në lidhje me pagesën e mëditjes që e keni gjatë këtyre takimeve që ne po hymë për vitin e dytë, por ne nuk e kemi as edhe një muaj që na është kompensuar, nuk është që nuk jemi munduar dhe kërkesën e juaj e kam përcjellë te kryesuesi i Kuvendit i cili bashkë me komitetet tjera e ka prezantuar para asamblesë. Sipas asaj rruge që shkon, çështja është problematike për me u zgjidhë për një kohë të gjatë, kështu që, ne jemi në bashkëbisedim me komunat e tjera duke u munduar që të gjejmë module, megjithëse të gjitha komunat e kanë të njëjtin problem, por do të mundohemi të gjejmë një rrugë dhe t'i kryejmë obligimet tona, sepse këto janë të parapara për t'u paguar. Ne jemi në diskutim e sipër për këtë edhe koordinatori ka filluar me mbledhjen e dokumenteve të nevojshme. Unë shprehi shqetësim dhe keqardhje nëse diçka nuk mund të ndodhë për shpejtë,

por besoj që bashkërisht kemi me ja dal, megjithatë, unë do të provojë edhe një opsion të cilin e kemi marrë nga komuna e Pejës, do ta provojmë edhe atë mundësi, përndryshe edhe mbas kësaj tentative që e kemi përmes asamblesë dhe kryetarit, do të detyrohem të ju them që kjo seancë është e domosdoshme; kjo mbahet, si u pagua, si nuk u pagua, por do të detyrohem ta mbaj brenda orarit të punës dhe kush ka mundësi të marr pjesë, merr pjesë, përndryshe është e domosdoshme. Ata të cilët për një arsye ose tjetër nuk dëshirojnë të jenë pjesëmarrës mund të zëvendësohen sipas rregullores dhe mua më duhet të konsultohem në aspektin ligjor se sa takime kanë të drejtë të mos jenë pjesëmarrës, sepse këtu kemi persona që në dy apo tri takime s'kanë qenë prezent dhe këtu duhet me parë se cilat janë procedurat, sepse sigurisht që mund të zëvendësohen me anëtarët tjerë. Unë isha e obliguar të ju jepja sqarim sepse kërkesat kanë qenë pothuajse nga të gjithë.

Në pikën e dytë të rendit të ditës, e kemi siguria dhe analiza e shkaktarëve të vjedhjeve në territorin e Komunës së Klinës, dhe para se me u ndalë të shkaktarët dhe me ja kaluar fjalën komandantit të Policisë, desha ta shprehë një shqetësim; është pak jashtë rendit të ditës të kësaj seance por e kemi në plan të KKS-së, është dhuna në familje, rastet e dhunës që na kanë shkaktuar indinjatë të gjithëve dhe jam e sigurt që dukuritë e tilla e destabilizojnë edhe vendin, komunën dhe një rreth shoqëror. Janë dukuri të shëmtuara të cilat urojmë shumë të jenë të fundit dhe shpresoj që përmes këtij Këshilli, përmes kësaj foltore, përmes jush që jeni anëtarë të institucioneve të ndryshme, të shprehim indinjatën tonë dhe zëri i protestës ose arsyes të dëgjohet dhe dukuritë të tilla të mos jenë më prezentë në shoqërinë tonë. Ne këtu kemi institucionet nga Policia e Kosovës, nga FSK-ja, kemi nga OSB-ja, nga KFOR-i, kemi katër institucionet fetare që janë shumë afër popullatës dhe përmes këtyre katër përfaqësuesve fetarë të komuniteteve që i kemi në komunën tonë, kisha kërkuar që përmes tyre të mundohen të vetëdijesojnë popullatën që gruaja është e shenjtë, është nënë, motër, është vetë jeta që Zoti vet e ka falë, e ka krijuar dhe ne duhet ta ruajmë dhe ta mbrojmë dhe jam shumë e sigurt që këta katër pjesëtarët që i kemi këtu, policia, niveli lokal, të mundohemi që të kontribuojmë që gjëra të tilla mos të ndodhin dhe të jenë pothuajse sa më minimale. Unë kërkoj falje nëse ndërhyra, por në plan e kemi edhe dhunën në familje dhe duke qenë një dukuri e tillë prezentë, mora guxim dhe e shpreha indinjatën time. Komandant, fjala për ju!

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Faleminderit, nënkryetare, përshëndetje për drejtorin dhe për të gjithë të pranishmit! Kur është puna te çështja e sigurisë, është çështja pak e ndjeshme dhe ndër pikat më të rëndësishme është kjo çështja e dhunës në familje, kështu që, normalisht që ne si stacion policor jemi të caktuar hetuesit të specializuar enkas për hetimin e këtyre dukurive, sepse edhe në zonën tonë të përgjithësisë nuk janë që nuk ndodhin kesi raste, por fatmirësisht kur krahasohet me zona të tjera ne jemi pak më mirë.

Zonën tonë të përgjithësisë në këtë tremujorshin e parë e kanë karakterizuar një sërë aktivitete të ndryshme, jeni të informuar që nga data 03 prill ka hyrë në fuqi Ligji i ri i komunikacionit dhe jemi dëshmitarë që një numër i madh i aksidenteve kanë ndodhur në Kosovë, por edhe në zonën tonë janë disa aksidente që kanë ndodhur me fatalitet dhe që nga data kur ka hyrë në fuqi ky ligj,

numri i aksidenteve është 60% më i ulët dhe vërehet që në ditët e para që ky ligj ka dhënë efektin në drejtimin e parandalimit të këtyre dukurive negative që po ndodhin në shoqërinë tonë. Që nga fillimi i vitit e deri më tani, kanë ndodhë 122 incidente të natyrave të ndryshme; kanë ndodhur 51 aksidente, ku 6 prej tyre janë me lëndime; 45 aksidente janë me dëme; janë 17 persona të lënduar dhe i kemi 3 aksidente me fatalitet dhe dashtë Zoti të jenë rastet e fundit.

Janë shqiptuar 3,536 gjoba; janë arrestuar 106 persona; prej këtyre incidenteve janë konfiskuar 10 armë, janë realizuar një numër jashtëzakonisht i madh i asistimeve me organizata tjera jashtë policore, prej rasteve më të ndjeshme që i kemi janë 2 raste me lëndime të rënda trupore; 7 raste me lëndime të lehta trupore; janë 3 vjedhje; 8 vjedhje të rënda dhe 9 raste të dhunës në familje. Do të thotë janë statistika nga janari e deri në fund të muajit të tretë nuk është numër i madh, me krahasuar me vitet paraprake numri i këtyre rasteve ka qenë dukshëm më i madh, dhe në këtë tremujorësh kemi rënie të madhe të këtyre incidenteve.

Çështje tjetër preokupuese është protesta e qytetarëve/bashkëfshatarëve tanë të fshatit Rixhevë-Gllarevë, që e kanë shfaqur një pakënaqësi, ku në një prej ditëve polica është detyruar që me përdorur pak edhe forcën. Kanë qenë të arrestuar tre persona, normalisht që ata e kanë të drejtën e protestës por në asnjë mënyrë mos me penguar personelin që tani veç e kanë fituar tenderin dhe rruga është duke vazhduar duke u punuar. Është pak shqetësuese, ne jemi këtu për ruajtjen e vendit dhe qetësisë dhe ne qytetarët i kemi afruar dhe nëse mendoni me protestuar dhe me bërë ankesa rreth asaj pike që ata po pretendojnë e kanë rrugën e qeverisë, ku qeveria i ka sjellë ato vendime dhe ne jemi të pafuqishëm për të ndikuar në atë drejtim, kështu që, shfrytëzoj rastin këtu të thërras të gjithë ata banorë që janë të pakënaqur mos të dalin sepse ajo është çështje e përfunduar dhe ne nuk mund të lejojmë që me penguar kompanitë që janë duke i kryer punimet. Prej rasteve të ndjeshme, sa i përket rasteve të tjera është një rast në fshatin Budisalc, e kemi një ankesë ditëve të fundit, jemi në fazë të grumbullimit të disa dëshmimeve, është një pronë që ka qenë në emër të një kombinatit, personeli i kishës i ka arritur procedurat për ta rikthyer atë pjesë më herët, por tash çka ka bërë shkalla e dytë nuk kemi informacione; jemi duke i grumbulluar dëshmitë dhe besoj që nesër ose pasnesër i sigurojmë të gjitha dëshmitë dhe dalim me një raport dhe i sqarojmë në detaje të gjitha. Kjo ishte në pika të shkurtra për zonën tonë të përgjithësisë, nëse keni ndonjë pyetje, unë do mundem me u përgjigj, atëherë, urdhëroni!

Znj. Silvia Rashkoviq: Përshëndetje dhe respekt për të gjithë! Lidhur me këtë rastin e fundit që e përmendët, unë doja të ju pyes se çka ka ndodhur aty? Dje kam biseduar me koordinatoren e juaj, me Xhevdetin dhe me Nikollën, që ishin në detyrë për këtë rast. Do të thotë toka në Budisalc të cilin manastiri ortodoks deri më tani edhe më herët e ka punuar pa asnjë pengesë dhe sipas zyrtarit tuaj derisa manastiri nuk dëshmon që është e tyre, nuk mund në të njëjtën kohë edhe ata të tjerët ai pronari i ri .

Gjykata ka marr vendim gojor që asnjëra palë të mos guxojë të punojë aty, dhe sipas policit ai i cili ka dëshmi që toka është e tij, të vazhdojë. Kisha kërkuar edhe nga ju që pak më në detaje ta hulumtojmë këtë rast, ajo është blerë diku në vitet 60-ta por nuk është përkthyer në kadastër dhe t'i kushtojmë vëmendje pak më shumë.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Toka për momentin është pjesë e kombinatit, manastiri i ka siguruar disa dokumentacione të vjetra që e ka blerë pala, e ka pasur një kontratë, po flas për vitin e kaluar, se sot kam filluar dhe nuk kam informacione rreth kësaj, por gjykata nuk mund të sjell vendim gojor për mos me punuar njëra palë ose tjetra, gjykata bie vendim me shkrim, por kjo do të trajtohet sikur çdo rast tjetër dhe shpresoj që ky epilog e merr ditën e nesërme një epilog ky rast, dhe nuk besoj që do të ketë probleme.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë! A ka dikush tjetër diçka? Paraprakisht me falni, unë e kam një udhëzim nga OSBE-ja, e kam një email nga Suadi i cili rastet e tilla që paraqesin ndonjë shkelje ligjore ose problematikë, qoftë ndërfitare, ndërprofesionalë në Këshillin që ne e drejtojmë, duhet të shprehet shqetësim. Unë gjithmonë ju kam drejtuar që dukuritë negative jemi munduar që të shprehim indinjatën tonë dhe ndihemi keq për raste të tilla. Ky rast ende është i parregulluar dhe as unë e as komandanti nuk mund të japim ndonjë epilog. Shprehi keqardhje dhe shpresoj që ky rast të zgjidhet në mënyrën e duhur dhe të fitojë pala që ka të drejtë, faleminderit!

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Vetëm sa për informacion, palë në këtë rast është AKP-ja me manastirin dhe nuk besoj që është rast problematik.

Z.Jeton Sokoli: E falënderoj Komandantin për raportin që e dha, e pata një pyetje lidhur me aksidentet me fatalitet që po ndodhin tash e sa vite afër hekurudhave. Aksidenti i fundit ka qenë në mars, ku një çift nga Deçani ka humbur jetën; ne e shohim se po thuajse çdo vit ka aksidente të tilla me fatalitet dhe desha ta di, a mund të marrim masa në mënyrë praktike që të shmangen këto aksidente? Unë nuk kam qenë në këto vende, p.sh., në fshatin Videjë apo në fshatrat tjera ku kanë ndodhur aksidentet, por e di që këtu afër ku kalon treni janë shenjat sinjalistike që lajmërojnë ardhjen e trenit por në vendet tjera duket që nuk ka dhe kishte me qenë mirë me marr masa të parandalimit, faleminderit!

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Është shqetësuese edhe për ju, edhe për ne. Për informacion, të gjitha vendkalimet mbi hekurudhë janë të pajisura me shenja të komunikacionit edhe vendi ku ka ndodhë aksidenti ka qenë i pajisur me shenja të komunikacionit. Unë si komandant i stacionit kam qenë shumë i shqetësuar sepse ndodhi rasti i dytë brenda vitit dhe e kam thirr një ekspert që është për parandalimin e rreziqeve dhe i bëra kërkesë me mbyllë me barriera kur të vjen treni, por me u mbyllë ashtu duhet të plotësohen disa kushte, dhe nga Fushë Kosova e deri në Pejë asnjë vendkalim nuk i plotëson, sepse duhet me qenë një numër shumë i madh i veturave. Në Klinë e kemi vendosur për shkak të rrezikut më të madh, por as në qendër të Klinës, rruga te QTA-ja nuk i plotëson kushtet e as në rrugën e Istogut, por janë vendosur, por këtu është pak problemi edhe tek vozitësit sepse po jemi shumë të pakujdesshëm dhe mbi 70% shkaktarë të këtyre aksidenteve është telefoni, është vështirë me përcaktuar aty për aty, por me bërë një

hulumtim të thellë del që shkaktar është telefoni dhe për këtë arsye masat janë shtrënguar. Biseda në telefon, 100 euro është dënimi i parë; 200 euro është i dyti; 300 euro i treti dhe; në fund edhe merret patentë shoferi. Unë jam që me shkuar 300 euro në start menjëherë, sepse në momentin që ti e merr telefonin, ti nuk je më në vozitje, por je diku tjetër i koncentruar.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit, komandant! Ne këtë e kemi pasur edhe si pikë të tretë të rendit të ditës dhe po besoj që do të vazhdojmë prapë në këtë temë. Nëse ka dikush tjetër diçka, sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës?

Don Jeton Thaqi: Përshëndetje për ju të gjithë! Desha edhe unë të flas diçka në lidhje me vjedhjet që ndodhin në komunën tonë. Besoj që është një preokupim edhe i familjeve, institucioneve dhe i çdo individ, po flas sikurse thonë njerëzit që policia i di por nuk ndërmarrin masa ose ndërmarrin pak; unë nuk jam ithtar me ju besuar atyre gjërave, por nuk është e mirë të dëgjohen këto fjalë ose dëgjohen raste që kapen hajnat dhe dënimet janë aq të vogla me një muaj burg ose të ngjashme dhe ata lirohen prapë dhe e përsërisin po të njëjtin rast. Hajnat nuk po i kursejnë as bashkësitë fetare, as kishat, e as xhamitë, edhe aty mendojnë me gjetur diçka sikur në vendet tjera. Nuk besoj që do të ishte keq që policia me pasur parasysh edhe pse besoj që e ka, por me pasur më shumë dhe t'i rrinë gati me ndonjë patrullë më shumë në bashkësitë fetare dhe në vendet ku ata shkaktojnë dëme më shpesh.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Personat që i shkaktojnë vjedhjet nuk zgjedhin as kishë, as xhami, as qytetarë, qëllim e kanë përfitimin në mënyrë të paligjshme. Ne e dimë që ka ndodhur edhe një rast në Zllakuqan, që ne kemi punuar me një volum shumë të madh të punës edhe pse për fat të keq deri më tani edhe pse jemi afruar shumë nuk kemi mundur me konkretizuar me një dëshmi që e kanë kryer. Shumë shpesh ndodhë edhe në vepra tjera, edhe në vjedhje, që dyshojmë që X personi ekziston mundësia që e ka kryer, por që kemi mungesë të fakteve.

Sa i përket masës së dënimeve është çështje e gjykatës që na preokupon edhe neve sepse ne po e bëjmë një punë shumë të madhe, një angazhim shumë të madh dhe në fund është dikush tjetër që e përcakton. Këto patrullime që ju po thoni, ne i kemi në planifikime ditore vizitat edhe në institucionet shkollore edhe fetare e në të gjitha institucionet, në baza ditore i frekuentojmë dhe i patrollojmë ne normalisht që jo çdoherë i mbajmë edhe kontaktet, sepse sa herë ne vijmë në kishë apo xhami, është edhe e mërzitshme të ju thërrasim e të bisedojmë sepse edhe mentaliteti ynë ende nuk ka mbërrirë në një shkallë që nëse e shohin policin duke biseduar me hoxhën, nuk do të thotë që ka diçka. Ne këtu jemi për me u mundur me bërë më të mirën, nëse ju keni ndonjë ide që është për të mirën e sigurisë, unë e përkrahi sepse nuk do të thotë që ne jemi ekspertë dhe çdo gjë e vendosim ne. Nëse ju keni diçka që ne mundemi me bërë, ndonjë ide që është kreative dhe në të mirë të shoqërisë, normalisht që ne do e realizojmë.

Z. Fitim Bojaj, hoxhë: Përshëndetje, nënkryetare, komandant, drejtor dhe ju anëtarë të pranishëm! Te pika e parë, te dhuna në familje, ne, të premtën e kaluar me rekomandim të

myftiut të Kosovës në të gjitha xhamitë e Kosovës është mbajtur një ligjëratë që i është kushtuar të drejtës së femrës, respekti, nderi që i bëhet asaj dhe përmes asaj ligjërate i kemi dënuar dy rastet e dy motrave tona që mizorisht javën e kaluar kaluan në botën tjetër nga ana e bashkëshortëve të tyre dhe këto raste të tilla dënohen dhe personat e tillë të marrin dënimin e merituar dhe këto raste të mos përsëriten kurrë më. Ta dimë se çka është e drejta e femrës që është shtylla e shtëpisë, e ardhmja e një vendi, prandaj duhet të vlerësohet, çmohet, respektohet në shkallen më të lartë, dhe e dyta siç e cekim edhe komandanti, të gjithë jemi ndjerë të prekur me rastin e protestës që ka ndodhur duke i parë ato skena, duke u sulmuar policia jonë, duke pasur edhe konflikte me banorët e asaj zone, ju e dini më mirë planin operativ tuajin por gjithmonë i huaji te ne ka respekt dhe vlerë më të madhe, ne nuk e duam tonin dhe me të vërtetë të gjithë jemi prekur me ato skena, faleminderit!

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, hoxhë! Nëse nuk ka dikush diçka tjetër, unë ju përgëzoj për iniciativën dhe po e përsëris edhe njëherë, nuk e besoj që ka institucion që nuk mund të ndihmojë dhe që nuk mund të ndërhyjë dhe t'i vetëdijesojë të rinjtë, që të minimizohen ose që gruaja të trajtohet në aspektin meritor. Jam shumë e sigurt që gjithçka fillon nga familja dhe po përfundon në këto raste në familje. Uroj shumë që kjo praktikë e juaja dhe praktikat tjera që praktikohen në institucionet tjera fetare, shkollore, ku këtu kemi edhe drejtorin e Arsimit, ku përmes drejtorive të shkollave, mësimdhënësve, lëndëve mësimore që kanë, është temë e cila diskutohet, ku nuk ka mbetur pa u sqaruar.

Unë mendoj që duhet me ndyshuar pak gjërat, po mendoj që guxoj ta them këtë, që në këto trajnime sensibilizuese duhet të thirren meshkujt dhe jo gratë, sepse dhuna po vjen nga ata dhe jo nga gratë. Kërkoj falje nëse u shpreha në këtë formë, por unë edhe në jetë jam kështu e drejtpërdrejtë. Problemi ynë nuk është se gratë nuk janë të vetëdijesuara me paraqitur problemin në polici; unë njoh shumë gra që përmes nënave na vijnë në institucione të cilat e kanë raportuar rastin, po situata aty nuk është zgjidhur, veç është përkeqësuar ende më shumë. Një grua, përderisa e raporton rastin, ajo largohet edhe një hap më shumë nga bashkëshorti dhe familja dhe asgjë nuk po mbetet konfidenciale, me gjithë respektin për gjithë policinë e sidomos në qytetin tonë, por vet gruaja është ajo që mund të del, ose i tregon, ose raporton dhe kjo është një shprehje popullore nëse prapë më lejohet me thënë që “buka që thyhet është vështirë të ngjitet” dhe kjo ndodhë edhe me nënat tona, vajzat tona të cilat kanë dhunë në familje, e raportojnë rastin por nuk bëjnë zgjidhje, dhe të gjitha këto raste kanë ndodhur në prag të shkurorëzimeve ose në një situatë ku është dëmtuar e thyer gjithçka. Për këtë arsye, unë për fund e falënderoj hoxhën dhe gjitha institucionet, por prapë thërras ndërgjegjësimit, jo raportim të grave, jo sensibilizim të grave, por burrave të cilët e quajnë veten burrë dhe që duhet patjetër të kujdesen jo vetëm për gratë, por ata burra kanë nënë, motër, kanë vajzë dhe kur ata e duan të mirën e këtyre tri të shenjtave, sigurisht që nuk ka me gabuar asnjëherë as me gruan e tij, faleminderit!

Z.Senad Ramaj: Unë desha të ndërlihem te pika e vjedhjeve në komunë, ju kisha drejtuar komandantit pas të akuzuarve dhe dëshmime që i japin ata, kisha dashur ta di se, sipas tyre, cili ka

qenë shkaktari që i ka shtyer me kryer një vepër të tillë dhe deri sot cilat kanë qenë dënimet maksimale që janë dhënë, qoftë në përgjithësi si informacion ose veç në komunën e Klinës? Cili ka qenë dënimi maksimal që është dhënë sa i përket vjedhjeve dhe diçka për fund, si polici sa kishte qenë e mundshme që ju me krijuar një strategji që me jua mundësuar gjeneratave të ardhshme me bërë një psiko-edukim sa i përket vjedhjeve? P.sh., me mbajtur ligjëratat nëpër shkollat ose me pasur edhe ndërhyrje edhe në literaturë shkollore, faleminderit!

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Policia e Kosovës në baza mujore i planifikon ligjëratat në shkollat në bashkëpunim me drejtorin e Arsimit dhe çdo muaj i ndërrojmë temat. Temat janë ato që ne i zgjedhim bashkërisht me institucionet arsimore dhe nevojave që paraqiten në terren dhe një ndër temat që ne e kemi ligjëruar në vazhdimësi ka qenë ajo e vjedhjeve dhe shkaktarët e vjedhjeve, dhe normalisht trajtimi i atyre personave pas përfundimeve të masave të dënimeve. Në bazë të statistikave që i kemi, vjedhjet kryesisht kryhen për shkak të përfitimeve pasurore, gjendja e dobët ekonomike, moskujdesi i prindërve dhe papunësia, do të thotë gjendja e dobët ekonomike i shtynë disa që t'i kryejnë këto vjedhje. Sa i përket masës së dënimeve, ato janë të përcaktuara sipas kodit të procedurës penale dhe asnjë rast nuk dënohet njëjtë, janë të parapara 6 muaj, 2-3 vite, 5 vite, varësisht forma dhe mënyra se si kryhet vepra penale.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, komandant! Nëse ka dikush diçka tjetër dhe nëse jo, atëherë vazhdojmë te pika e tretë e rendit të ditës.

Pika 3. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e Komunës

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Për këtë pikë biseduam pak dhe e kemi diskutuar edhe në takimet tjera, mirëpo e kemi të renditur në plan dhe nuk është e tepërt asnjëherë të flitet për tema të tilla, sepse këto e bien edhe rrezikun, e kanosin lirinë dhe jetën e qytetarëve. Ne gjithmonë jemi në koordinim me drejtorinë përkatëse, inspektoratin, ku kemi bërë kërkesat që kanë dalë nga KKSJ-ja dhe nga qytetarët e tjerë të cilët kanë shprehur shqetësimet e tyre në lidhje me mungesat e shenjave. Janë bërë përmirësime, e tregoi edhe më herët komandanti në tri-katër pika, ku problemi ka qenë te hekurudha, por jo të gjitha problemet i takojnë nivelit lokal, disa i takojnë nivelit qendror dhe duhet bashkëpunim mes nivelit lokal, policisë dhe nivelit qendror, sepse shpenzimet janë shumë të mëdha dhe është vështirë të mbulohen. Por pjesa tjetër e sinjalizimeve, pos që duhet ta themi sepse nuk jemi pa të meta, diku mungojnë nga pakujdesia, diku mungojnë edhe nga pakujdesia e qytetarëve të cilët i dëmtojnë dhe shumë shpesh këto vendosen dhe rivendosen, mirëpo, ne të gjithë duhet të jemi koshientë dhe aty ku ka probleme të raportohen.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Ligji i ri i komunikacionit parasheh edhe sinjalizimin horizontal

dhe vertikal dhe autorizimet që i ka niveli komunal, i ka obligim ligjor. Niveli komunal, pajisjen, vendosjen e shenjave të komunikacionit, e ka obligim ligjor, dhe masa ndëshkuese ku për nivelin komunal është shumë i ashpër dënimi, është nga 3000 deri në 5000 euro për një shenjë të komunikacionit. Niveli komunal ka obligim ligjor me këtë ligjin e ri që ka hyrë në fuqi, mirëpo me këto kapacitete që i kemi pasur deri tani, sidomos sinjalizimin vertikal është mbi 90% i kompletuar. Sa për kureshtje, aksidenti i fundit që ndodhi në Krushevë të madhe, ka ardhur një komision nga Prishtina, ekskluzivisht me shikuar a ka shenja horizontale dhe vertikale, ekskluzivisht për nivelin komunal, ta keni parasysh që në atë aksident mos të ishin shenjat vertikale, fletëparaqitja penale ju kishte paraqitur edhe personelit komunal për mosvendosjen e shenjave. Kështu që, ta kemi parasysh që edhe niveli komunal bashkërisht sepse edhe ne jemi pjesë këtu edhe ne kemi obligim ligjor sa i përket kësaj pike.

Z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA-së: Përshëndetje, nënkryetare, faleminderit juve që keni marr pjesë! Pasi që jemi te trotuaret, po e shtoj edhe unë një pjesë që kryetari i Komunës çdo vit ka shtime të trotuareve në shumë fshatra sepse edhe ajo është një pjesë e kontributit në siguri. Ne e kemi tash edhe në Zajm, kam kërkuar te pjesa e shkollës në atë pjesë ku ka lëvizje të nxënësve, ne e dimë që gjendja e sigurisë dhe vozitja nuk është në duar të policisë, për shkak se nuk mund të jenë të vendosura gjatë gjithë kohës nëpër rrugë, por, po kemi shumë rrezikshmëri e po flas sidomos për nxënës dhe kur e kemi një trotuar që është tamam me standarde qysh duhet, atëherë besoj që është një diçka shumë e mirë dhe komuna e Klinës ka filluar në shumë fshatra që të vendosen trotuaret, që së paku nxënësit të kenë një hapësirë që ecin lirshëm, faleminderit!

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, drejtor! Trotuaret dhe ndriçimi i rrugëve afër shkollave dhe institucioneve është i vendosur, kanë mbetur edhe ndonjë pjesë në zonat rurale por në planifikimin dy vjeçar e kemi edhe pjesën tjetër të trotuareve dhe ndriçimit aty ku mungon, do të thotë, të gjitha fshatrat do të kenë mundësinë që të kenë trotuaret dhe ndriçimin, është një pjesë që është paraparë në buxhet. A ka dikush të shtojë diçka?

Z.Elmi Zenunaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë kisha me dhënë një propozim tek stacioni i autobusëve, dy pengesa, sikurse janë bërë kah "Sefermanët", sepse po besoj që është një vend që ka nevojë, sepse ka nxënës dhe shpejtësia e madhe që është aty mund të vijë deri te ndonjë aksident.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë! Sa i përket pengesave, ndoshta komandanti i policisë e di më mirë janë disa rrugë që nuk lejohen, unë kam bërë kërkesë në të kaluarën në disa rrugë kur isha mësimdhënëse dhe drejtoreshë shkolle dhe nuk është lejuar asnjëherë, mirëpo, kjo pjesa ku thua ti, nuk është rrugë rajonale sepse janë disa rrugë që thuhet se nuk lejohet edhe ky shtrimi i trotuareve nuk shkon përmes inspektoratit.

Komandanti, z.Ragip Bytyqi: Duhet me u bërë një analizë sa kemi pasur aksidente dhe sa ka


paraqitur rrezikshmëri, dhe duhet me i pyet ekspertët e komunikacionit, por në bazë të atyre njohurive që unë i kam, ka lëvizje të shumta të autobusëve dhe nuk preferohet, por duhet të këshillohemi me ekspertët e komunikacionit.

Z. Shemi Bajraktari: Përshëndetje, desha një sqarim shtesë sa i përket rrugës së stacionit të autobusëve, se vitin e ardhshëm është projekti që është mbi projekt i ri, që ka me u bërë një trotuar shumë i mirë dhe ka me pasur gjerësi më të madhe, dhe po besoj që me trotuar të ri mbulohet gjithçka.

Zv.Kryesuesja, znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit, Shemi! A ka dikush diçka tjetër tek pika e fundit e rendit të ditës, të ndryshme? Nëse jo, atëherë, unë uroj që kërkesat e juaja të gjitha të realizohen sa më shpejt.

Nënkryetarja e mbylli takimin duke i përshëndetur dhe falënderuar të gjithë!

**Procesmbajtësja,
Orgeta Sylaj**



**Zv. KRYESUESJA,
Marqe Tanushi-Selmanaj**

